

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU
---	--	---

SCA – 08 – 0066

24 shkurt 2011

[REDACTED], Deçan
kundër
[REDACTED], NP, Pejë

Paditës/Ankues
E paditur

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Trupi Gjykues i përbërë nga Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese, Katarina Entcheva dhe Sabri Halili, gjyqtarë, pas shqyrtimit të ankesës të dorëzuar kundër Aktgjykimit II.C.no.161/2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, datë 3 tetor 2007, nga paditësi [REDACTED], **Kompani Private, Deçan**, në lëndën kundër [REDACTED] NP, Pejë, lidhur me pagesën e 14.071,065 eurove si kompensim për fitim të paligjshëm, plus interesin ligjor dhe shpenzimet procedurale, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 shkurt 2011, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Hiqet pezullimi i procedurës në këtë lëndë, i vendosur në bazë të Vendimit Ekzekutiv të UNMIK-ut 2008/34 i datës 29 korrik 2008.
2. Ankesa e “[REDACTED]”, kompani tregtare dhe shërbyese nga Deçani refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi II.C.no.161/2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, datë 3 tetor 2007, vërtetohet.
3. Ankuesi obligohet që të paguajë taksat gjyqësore në shumë prej 148 euro për lëshimin e aktgjykimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 13 qershor 2008, “[REDACTED]”, kompani tregtare dhe shërbyese nga Deçani, ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Aktgjykimit II.C.no.161/2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, të datës 3.10.2007, i cili kishte refuzuar si të pabazuar padinë e saj përmes se cilës i ka kërkuar “[REDACTED]” pagesën e 14.071,065 eurove si kompensim për fitim të paligjshëm, plus interesin ligjor, duke filluar nga data 20.10.1999 deri në datën e pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet procedurale.

Ankuesi i kërkon Dhomës se Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit që të ndryshojë aktgjykimin e

kundërshtuar ose ta anulojë atë dhe ta dërgojë çështjen pranë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Ankesa i është dërguar të paditurit “████████” nga Peja, por Dhoma e Posacme nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Arsyet ligjore

Më 20 tetor 1999, palët kishin nënshkruar një kontratë qiradhënje nr. 229, me anë të së cilës ankuesi/qiradhënsi “████” kompani tregtare dhe shërbysese nga Deçani mori obligimi që t'i vinte në dispozicion të paditurit “████”, autobusin e saj, për të operuar në linjën Pejë-Prishtinë dhe në kthim. Sipas kontratës së qiradhënieve, do të paguhej një tarifë e përgjithshme për çdo hyrje dhe dalje nga Stacioni i Autobusëve i █████. Neni 5 i kontratës parashikonte që qiradhënsi “████” kishte të drejtë të merrte fitimet nga shitja e biletave të autobusit, me kusht që t'i paguante qiramarrësit █████ çdo herë ekuivalentin e çmimit të pesë biletave, në shumën prej 30 DM.

Me aktgjykimin II.C.no.161/2006, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, të datës 3 tetor 2007 e refuzoi si të pabazuar padinë e paditësit kompania █████ që kërkoi nga “████” pagesën e 14.071,065 eurove si kompensim për fitim të paligjshëm, plus interesin ligjor (që do të llogaritej duke filluar nga data 20 tetor 1999 deri në datën e pagesës përfundimtare), si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e Qarkut kishte vërtetuar se në këtë çështje ajo kishte të bënte me një kontratë qiradhënje dhe jo me një kontratë për parkimin e autobusit në parkingun përkatës të rezervuar; (lidhur me precizimin e padisë, kjo Gjykatë vëren se Paditësi pretendonte se tarifa e ngarkuar për këto shërbime shpesh ishte dyfish ose trefish krahasuar me tarifën e ngarkuar autobusëve të tjera të cilët ofronin të njëjtat shërbime). Në padinë fillestare të regjistruar në Dhomën e Posacme më 28 shkurt 2006 Paditësi pretendon që fitimi i paligjshëm të jetë shkaktuar nga pagesa e kërkuar ose për qira ose për parking. Në seancën e fundit dëgjimore të mbajtur më 3.10.2007 Paditësi deklaroit se tarifa e paguar e akomodimit nuk ishte borxh i Paditësit dhe se shuma ishte shumë më e lartë se që janë ngarkuar kompanitë tjera.

Gjykata e Qarkut ka gjetur se për shumën e mësipërme që duhej të paguhej ishte rënë dakord me vullnet të lirë ndërmjet palëve në kontratën e tyre të qiradhënieve. Prandaj ajo e ka refuzuar padinë e █████ si të pabazuar, përmes së cilës ka kërkuar që t'i kthehej shuma prej 14.071,65 eurosh, në bazë të fitimit të paligjshëm.

Një tjetër argument i të paditurit në Gjykatën e Qarkut ishte se padisë së “████” i kishte kaluar afati. E paditura argumentoi se në bazë të Ligjit mbi Detyrimet, paditë që bëhen për kontrata shërbimesh parashkruhen pas 3 vjetësh. Kontrata është bërë më 20 tetor 1999 dhe padia ishte ushtruar më 8 mars 2004, kështu që padia ishte parashkruar.

Gjykata e Qarkut i gjeti këto pretendime të pabazuara sepse në këtë rast, padia ishte për fitim të paligjshëm, prandaj, sipas nenit 371 të Ligjit mbi Detyrimet, zbatohet afati i zakonshëm i parashkrimit prej 10 vjetësh.

Aktgjykimi i është dërguar Paditësit më 7 dhjetor 2007 dhe të Paditurit më 6 dhjetor 2007.

Më 6 shkurt 2008 (regjistruar më 13 qershor 2008) paditësi/ankuesi, ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Aktgjykimit II.C.no.161/2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, datë 3 tetor 2007.

Ankuesi i kërkon Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit që të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ose ta anulojë atë dhe ta dërgojë çështjen pranë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në ankesën e tij ankuesi pretendon se para luftës, nuk ishte praktikë pune për linjat e udhëtimit që të ishin të regjistruala pranë Ministrisë përkatëse. I vetmi organ kompetent për caktimin e këtyre linjave të udhëtimit ishte Shoqata e Transportuesve në Pejë e cila e kishte caktuar ankuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një vërtetimi të datës 25 shtator 1999 (është paraqitur kopja). Kështu që, sipas ankuesit, e paditura [REDACTED] në kontratën e saj që madje nuk duhej të ishte emërtuar "kontratë qiradhënie", ia kishte shitur ankuesit të drejtën për të përdorur linjën e udhëtimit të cilën as ai vetë nuk e posedonte. Ankuesi parashtron gjithashtu se pas luftës, Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit e sapo formuar, ia kishte lejuar ankuesit që të përdorte të njëjtën linjë udhëtimesh.

Ankuesi pretendon se, në fakt, autobusi i tij kurrë nuk ka bërë ndonjë shërbim për të paditurën, ashtu siç ishte parashikuar në kontratën e qiradhënieve. Ai vetëm ka paguar në mënyrë të rregullt së paku dy herë për parkimin e autobusit, krahasuar kjo me atë ç'farë ishte paguar nga transportuesit e tjera. Madje, ajo duhej të paguante edhe kur autobusi i saj nuk udhëtonte fare.

Ankesa i ishte dërguar të paditurit "██████████" nga Peja, por Dhoma e Posaçme nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme vendosi që të refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Ankesa refuzohet si e pabazuar pasi që nga faktet që vërtetohen nga Dhoma e Posaçme nuk është gjetur asnjë provë e prejudikimit të pretenduar. Sipas llogaritjeve të paditësit, për periudhën në vitin 1999, ishte paguar një tarifë për parkim në shumë prej 30 DM. Kjo është një deklaratë e ndryshuar në padi pasi që fillimisht paditësi kishte pranuar se pagesat ishin bërë ose duke marrë parasysh përdorimin e linjës së autobusit ose për hyrjen në stacion. Për periudhën e vitit 1999 raportet mes palëve ishin rregulluar me marrëveshjen me shkrim dhe nuk mund të bëhet krahasim me pagesat tjera që përbën tarifën për parkim pasi që tarifa e paguar nga paditësi ishte qiraja (duke përfshirë me sa duket tarifën për parkim të autobusit). Dhe çmimi për qiranë e paguar ishte i negociuar.

Sa i përket periudhës pas vitit 2000, marrëveshja e palëve nuk ishte bërë me shkrim por nuk kontestohet se pagesat ishin bërë nga paditësi për të paditurin. Sipas librit të regjistrimit, mes palëve janë bërë 2 lloj pagesash. Supozohet se ajo më e larta është

për qiranë e linjës së autobusit dhe më e ulëta është tarifa për parkim. Kjo është ajo pse të gjitha llogaritjet – që i referohet pagesave të bëra nga paditësi të jetë tarifë për parkim – por të cilat janë çmimi për qiranë e linjës së autobusit – nuk mbështeten me prova. Pasi që paditësi nuk ka dëshmuar ndonjë të drejtë përdorimin e linjës së autobusit në këtë periudhë, gjykata konstaton se kontrata e qiradhënieve kishte vazhduar dhe Paditësi kishte bërë pagesat për qiranë e autobusit dhe për parkim. Sa i përket letrës së datës 25 shtator 1999 ky dokument duk dëshmon të drejtën përdorimin e linjës së autobusit.

Sa i përket domosdoshmërisë së verifikimeve plotësuese, Gjykata konstaton se Paditësi nuk ka ofruar asnjë indikacion nga i cili mund të zbulohet sjellje e paligjshme e të Paditurës ndaj Paditësit. Paditësi është kompani me aktivitet komercial të vazhdueshëm dhe nga paditësi kërkohet një standard i kujdesit në lidhje të marrëveshjes. Kjo është arsyja pse verifikimet tjera janë parë të panevojshme për të kontrolluar nëse i padituri ka përdoruar tarifa të ndryshme për kompani të ndryshme. Fitimi i paligjshëm i pretenduar mund të konstatohet vetëm kur të gjendet fajësia në sjelljen e të paditurës (siç definohet me nenin 158 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve) dhe nuk është dhënë asnjë indikacion i qëllimit të paligjshëm apo neglizhencës së të Paditurës që do të kishte përcaktuar gatishmërinë e paditësit për të bërë ato pagesa.

Taksat gjyqësore

Sipas Rregullave Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore, të DHPGJS-së, në fuqi nga data 10 mars 2010 (në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6), për këtë procedurë vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifa e taksës gjyqësore, neni 10.11 (ushtimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa e taksës gjyqësore, neni 10.21 në lidhje me 10.12 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	118 Euro
Gjithsej	148 Euro

Taksa gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit siç rregullohet me nenin 10.21 në lidhje me nenet 10.12 dhe 10.1 të Tarifës së Taksës Gjyqësore do të përcaktohet sipas vlerës së padisë. Pasi që vlera e padisë është 14.071.065 euro, gjykata vendos taksën gjyqësore për aktgjykimin në shkallë të dytë sipas 10.1 që është 118 euro (për paditë mbi 10.0001 euro – 50 euro + 0.5% deri në maksimumin prej 500 euro).

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi i cili është i obliguar që të paguajë shumën e cekur në Dhomën e Posaçme.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të parashistrohet pranë kolegit të ankesave të Dhomës së Posaçme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese EULEX (nënhkrimi)
Katarina Entcheva, Gjyqtare EULEX (nënshkrimi)
Sabri Halili, Gjyqtar (nënshkrimi)
Tobias Lapke, Regjistrues EULEX (nënshkrimi)

